

**VENDIM**  
**Nr. 1026, datë 27.11.2013**

**PËR LEJIMIN E SHTËPISË BOTUESE TË TEKSTEVE MËSIMORE PËR KRYERJEN E  
PROCEDURËS SË PROKURIMIT, ME OBJEKT “PËR SHTYPJEN E TEKSTEVE  
MËSIMORE” DHE BOTIMIT TË ÇDOLLOJ NJOFTIMI PROKURIMI PËR KËTË SHËRBIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore për kryerjen e procedurës së prokurimit, me objekt “Për shtypjen e teksteve mësimore”, me fond limit 2 715 000 (dy milionë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, miratuar në buxhetin e vitit 2013 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, dhe botimit të çdolloj njoftimi prokurimi për këtë shërbim, brenda datës 31 dhjetor 2013. Brenda këtij afati përfshihen lidhja e kontratës përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**